



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01 Nr.104/02-14613/26

Kaçanik, 29.06.2026

Duke u bazuar në nenin 12.2 lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale , neni 6 (h) i Statutit të komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas Statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.3558/2008 të datës 25.09.2008), Kuvendi i komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2026 merr :

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01Nr.941/01-11177/21 , i datës 29.04.2021, PËR LEJIMIN E NDARJES SË PARCELËS NR.649-0 ZK KAÇANIK PSH SHTËPIA SHËNDETIT, PËR NDËRTIMIN E SHTËPISË INTEGRUESE

1. Me këtë Vendim bëhet **Shfuqizimi** i Vendimit nr.941/01-11177/21 i datës 29.04.2021 , Për lejimin e ndarjes së parcelës nr.649-0 ZK Kačanik PSH Shtëpia Shëndetit, për ndërtimin e Shtëpisë Integruese.
2. Shfuqizimi i Vendimit nga pika 1 bëhet për arsye që, ky vendim nuk është ekzekutuar asnjëherë dhe, për rrjedhojë, nuk janë ndërmarrë veprime administrative apo investuese për realizimin e tij. Ndërkohë, bazuar në nevojat aktuale të komunës dhe planifikimin e zhvillimit të infrastrukturës publike, është vlerësuar se në të njëjtin lokacion ekziston interes publik për realizimin e një projekti tjetër, konkretisht ndërtimin e një parkingu nëntokësor, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e qarkullimit, menaxhimin e hapësirave për parkim dhe rritjen e funksionalitetit të zonës.

Për shkak se vendimi i datës 29.04.2021 ka mbetur i paekzekutuar dhe qëllimi për të cilin është nxjerrë nuk do të realizohet, shfuqizimi i tij është i nevojshëm për të krijuar bazën ligjore dhe administrative për procedimin e projektit të ri, në përputhje me interesin publik dhe dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. Ky Vendim hy në fuqi pas miratimit në Kuvendin komunal , 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e komunës së Kaçanikut.
5. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ,obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të bëjë ndryshimet në Regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme në komunën e Kaçanikut.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit

Selajdin Troni